



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM
Nr 62 Datë 14.07.2010

**PËR DISA SHTËSA NË PRIORITETET E INVESTIMEVE
PËR VITIN 2010**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban e Hartimit të Projekteve në Infrastrukturë dhe Drejtoria e Financës, "Për disa shtesa në prioritetet e investimeve për vitin 2010", mbështetur në :Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore "neni 32 pika dh ,ligji 10190 dt.26.11.2009 " Për buxhetin e vitit 2010",Udhëzimin Nr.1 datë 21.01.2010 " Për zbatimin e Buxhetit për Vitin 2010", ligji nr. 9936 dt.26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "dhe ligji nr. 8399 dt.09.09.1998 " Për buxhetin lokal ", në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

I. Të miratojë shtesë në listën e prioriteteve të investimeve për vitin 2010 miratuar me vendim nr datë edhe objektet si më poshtë vijon:

3. Rikonstruksion i rrugëve në lulishten "Shën Mëria" me fondin prej	10.000.000 lek
2. Rikonstruksion në pallatin e sportit "Tamara Nikolla"me fondin prej	30.000.000 lek
3. Rikonstruksion i basenit ujqor tek Parku "Rinia" me fondin prej	5.000.000 lek
4. Ndërtim i zyrës së informacionit turistik me fondin prej	7.000.000 lek

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projekteve në Infrastrukturë, Drejtoria e Financës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

GJERGJI PENDAVINJI